



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 23 datë 21 /12/2022

“PER SHTIM DHE NDRYSHIM ORARESH NË LINJËN RRETHQYTETESE TE TRANSPORTIT TE UDHETAREVE POJAN-KORÇË-KTHIM”

Mbështetur në ligjin Nr. 8308, dt 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), neni 15, pika 1, gërma “ç” dhe paragrafi i dytë i nenit 19, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI:

1. Të shtojë dhe të ndryshojë oraret për linjën Pojan-Korçë- kthim të kërkuar nga Bashkia Maliq për plotësimin e nevojave të banorëve, linja ekzistuese është miratuar me vendimit Nr. 3, datë 17.03.2021.

Nr	Bashkia kërkuese	Linja rrethqytetëse	Nr.i orareve të shërbimeve në linjë
1	Bashkia Maliq	Pojan– Korçë - Kthim	Nisja 06:50, 07:00, 07:45, 08:20, 08:30 ,09 15, 10:00, 10:45,11:30,12:15,13:00,13:45,14:30,15:15,16:00 Kthim 07:30,08:15,09:00,09:45,10:30,11:15,12:00,12:45,13:30, 13:40,14:15,15:00,15:45,16:30,17:30

2. Oraret janë sipas kërkesës së Bashkisë Maliq, pikat e nisjes dhe të mbëritjes do të jenë ato ekzistuese.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Bashkia Maliq, subjektet e transportit të udhëtarëve .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI

Konceptoi: Oljona Beqiraj
Jurist: Gjergji Kristo
Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muç





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

Për shtimin dhe ndryshimin e orareve në linjën Pojan-Korçë-Kthim

Në datën 09.12.2022, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, është paraqitur kërkesa e Bashkisë Maliq për shtimin dhe ndryshimin e orareve në linjën Pojan-Korçë-Kthim.

Këshilli i Qarkut Korçë me vendimin Nr. 03. date 17.03.2021 “Për miratimin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve, ka miratuar linjat rrethqytetëse mbi bazën e të cilave ushtrojnë aktivitet subjektet që operojnë në fushën e transportit në Bashkinë Maliq.

Duke marrë parasysh kërkesat e shumta të banorëve të fshatit Pojan për lëvizjen e tyre drejt qytetit të Korçës dhe interesimin e shoqërisë që operon në këtë linjë ,është kërkuar nga BashkiaMaliq shtimi dhe ndryshimi i orareve në linjën përkatëse për t’ju shërbyer plotësisht banorëve.

Dokumentacioni i paraqitur është konform Ligjit Nr.8038, datë 18.03.1998 ”Për transportet rrugore”, në këto kushte i propozojmë Këshillit të Qarkut miratimin e kërkesës.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI

